



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ Prot

Datë _____ . _____ . 2024

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje kontenierë metalikë për mbledhjen e mbetjeve urbane në Bashkinë Përmet”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
44613800-8 - Kontenierë për mbeturina

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 1 890 825 (një milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë e tetëqind e njëzetë e pesë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Përmet** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 7, pika 1 ”Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”

2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3(tre) vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të fondit limit që prokurohet.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40 pika 4 si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20% të vlerës së fondit të limit që prokurohet që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë apo mundësinë e OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe se nuk sjell kufizim të konkurrencës. Kjo vlerë është brenda limiteve të përcaktuara në LPP, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë çertifikata cilësie në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Certifikata e kërkuar është si më poshtë:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi (ose me qera), një mjet transporti me kapacitet minimal 7.5 ton për të bërë transportimin e mallit të vërtetuar me dokumentacion si (leje qarkullimi, siguracionin e mjetit, çertifikatën e kontrollit teknik, çertifikatë pronësie të mjetit dhe leje për transport mallrash të vlefshme).

Shënim: Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4.Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.** 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje

interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 6/d** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:... d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 15.03.2024, ora 11:00.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje kontenierë metalikë për mbledhjen e mbetjeve urbane në Bashkinë Përmet”.

Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit.

NJËSIA E PROKURIMIT

MIRATOI
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Alma HOXHA